# DËSHMI ARKIVI

**A-437396**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Ministrja Spahiu merr detyrën: Në qendër të punës qytetari, prani besnike në çdo institucion të sistemit s hëndetësor |
| ADRESA | `https://kohajone.com/lajme/ministrja-spahiu-merr-detyren-ne-qender-te-punes-qytetari-prani-besnike-ne-cdo-institucion-te-sistemit-shendetesor/` |
| BURIMI | kohajone.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 18:10:05 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 18:00:30 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3b6d52334197527f0709be4d77e335ce3eeb4fce988616cb89b787f45242e503` |
| TEKSTI | `298eba576615a1a308b9d3fcb84e22f31407f87ed78b8a051bd0ab1f76daadd0` |
| PAMJA | `d7045fd8e9fee2b333cf731278ce94a07ec3d52a49501ab6aaa5a7d8773da398` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `c1d4206ad9dc5c9e74a2c4fe6aebe3a35e2508e0519f43553638d3fb9f9baba3` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `648cf5643b7eec9631eeb9308ec676d258ca5b066518a7d2fcbfc98479d63336` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/c1d4206ad9dc5c9e74a2c4fe6aebe3a35e2508e0519f43553638d3fb9f9baba3`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Ministrja Spahiu merr detyrën: Në qendër të punës qytetari, prani besnike në çdo institucion të sistemit shëndetësor

LAJME E PREMTE, 11 SHTATOR 2026 20:00



Ministrja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Klodiana Spahiu, ka marrë sot zyrtarisht detyrën, pas betimit në prani të Presidentit Bajram Begaj. Në takimin prezantues të ministres së re në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ishte e pranishme zv/kryeministrja Albana Koçiu, e cila vlerësoi kontributin e Klodiana Spahiut në sektorin e shëndetësisë, njohjen e prioriteteve të këtij sektori, si dhe angazhimin e saj ndër vite në adresimin e çështjeve me interes për qytetarët.

*"MSHMS tashmë do të drejtohet nga Klodiana Spahiu, e cila, për background-in e saj, së pari është mjeke dhe është një njohëse shumë e mirë e të gjitha prioriteteve që MSHMS ka pasur ndër vite, si dhe një lobuese shumë e mirë për të gjitha çështjet që kërkojnë vëmendje, jo vetëm nga ligjvënësit, por edhe për qytetarët. Ka qenë mbështetëse e jashtëzakonshme për të gjitha ato çështje me të cilat jeni përballur të gjithë ju"*,-tha Koçiu.




Zv/kryeministrja Koçiu vlerësoi gjithashtu punën e ministres paraardhëse, prof. Evis Sala, si dhe rezultatet e arritura gjatë drejtimit të saj. Ajo nënvizoi rëndësinë e vijimit të reformave, ndër të cilat reformimi i shërbimit onkologjik dhe ngritja e Institutit të Onkologjisë në QSUT, avancimi i autonomisë spitalore, reformimi i strukturës së shërbimit spitalor dhe atij parësor, si dhe përafrimi i mëtejshëm i legjislacionit shqiptar me atë të Bashkimit Evropian.

Ministrja Klodiana Spahiu theksoi rëndësinë e një institucioni më të hapur dhe më pranë qytetarëve, duke vendosur dëgjimin dhe adresimin e problematikave në qendër të punës së Ministrisë dhe institucioneve shëndetësore. *"Duke filluar që nesër do të kemi një zyrë të hapur që në orën 08:00 të mëngjesit, për të adresuar dhe dëgjuar një problematikë që*

LAJMET KRYESORE


"S'kam folur me Trump për projektin", Rama për Sazanin: Ishulli nuk shitet, në Zvërnec ndërtohet një spital i nive...


Rama kritikon Gjykatën Administrative: Për rrogat e veta hapin dyert e thesarit, por jo për hallet e qytetarëve


Berisha në Amerikë, takim me kongresmenin Joe Wilson: Në fokus droga, zgjedhjet dhe qeveria teknike


Ministri Malaj u përgjigjet gjyqtarëve: U shkon paga 567 mijë lekë, 165 milionë euro ikin nga buxheti


"Eja Besfort në Kryeministri!"

TË PËRZGJEDHURA


Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!


Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve


Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it


Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca


Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONE-DEBAT: Nuk votoj kandidat me "njoftim"!

MË TË LEXUARAT

*nuk është zgjidhur diku tjetër. Për këtë qëllim do të angazhohemi të gjithë ne. Të njëjtën gjë do ta bëjnë të gjitha institucionet shëndetësore terciare që janë këtu. Që nga ky moment, kjo do të jetë prania jonë besnike dhe insistoj në çdo moment që në rastet kur do të kemi problematika apo mungesa, ato të vijnë duke u pakësuar dhe duke u përmirësuar, sepse ky është një proces në evoluim".*

Ministrja Spahiu falënderoi stafet e sistemit shëndetësor për punën dhe kontributin e tyre, ndërsa prezantoi vizionin e saj për drejtimin e sektorit dhe vijimin e objektivave për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore. Ajo vendosi theksin te besimi dhe bashkëpunimi brenda sistemit, si bazë për të çuar më tej rezultatet e arritura dhe për të përcaktuar objektiva të qarta, afatshkurtra dhe afatmesme.

*"Unë kam 13 vite që e zhvilloj me ju betejën e shëndetësisë. Sfida është e shumëfishtë. Sfida e parë është për besimin dhe këtë mos e harroni, sepse secili nga ne duhet ta ketë këtë si qëllimin kryesor. Dhe unë, të paktën, këtij parimi nuk i ndahem. Dua që ne të shohim përpara dhe objektivat që do t'i vendosim vetes, afatshkurtra dhe afatmesme, të kenë një deadline".*

**Profili i ministres Klodiana Spahiu**

Dr. Klodiana Spahiu është mjeke kardiologe dhe mban titullin "Doktor i Shkencave Mjekësore". Ajo është diplomuar në Mjekësi të Përgjithshme në Fakultetin e Mjekësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1997 dhe është specializuar në Kardiologji pranë QSUT-së gjatë viteve 1998–2002.
Ka kryer trajnime të avancuara në kardiologji joinvazive dhe invazive në Itali, si dhe studime pasuniversitare dhe një master profesional në Menaxhim Shëndetësor.
Përvoja e saj profesionale përfshin ushtrimin e profesionit si kardiologe, drejtimin e Spitalit të Durrësit dhe angazhimin në mësimdhënien universitare.
E zgjedhur deputete e Kuvendit të Shqipërisë në vitin 2009, ajo ka vijuar aktivitetin parlamentar dhe, në vitin 2025, u emërua Nënkryetare e Kuvendit.
Dr. Klodiana Spahiu sjell në drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale një përvojë të gjerë mjekësore, akademike dhe institucionale.





ETIKETA KLODIANA SPAHIU

## MË SHUMË NGA LAJME

VIDEO/ Rrëfimi i Ramës: Kam qenë rebel, por jo i bullizuar. Më kanë d...

Diaspora në protestë kundër Ramës, aktivisti akuza për bllokimin e ma...

25-vjetori i sulmeve terroriste, presidenti Trump: Nuk do ta harrojmë...

Drejtori Hita shpalos prioritetet e Policisë: Luftë armëve, drogës dh...

Shkëlqim Hajdari në Bronx: Do të jetë përkrah bashkatdhetarëve në mbë...

Reforma e sistemit të inspektimeve, Sula: Kontrollet do të bazohen në...

## LAJMET E FUNDIT



Ministrja Spahiu merr detyrën: Në qendër të punës qytetari, prani besnike në çdo institucion të sistemit shëndetësor

9 MINUTA MË PARË

”S’kam folur me Trump për projektin”, Rama për Sazanin: Ishulli nuk shitet, në Zvërnec ndërtohet nj...

19 MINUTA MË PARË

Rama: Në Zvërnec do të ndërtohet një spital i nivelit të lartë

26 MINUTA MË PARË

Rama zbulon si do të zbatohet “Besa”: Pasqyra bëhet ligj

43 MINUTA MË PARË

Rama: Sulmet kibernetike ndaj Shqipërisë kërkojnë verifikim ndërkombëtar të autorësisë, kemi kapacitete të avancuara

48 MINUTA MË PARË

VIDEO/ Rrëfimi i Ramës: Kam qenë rebel, por jo i bullizuar. Më kanë dhunuar vetëm dy herë

54 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

Gazeta **"KOHA JONË"** themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991
Botues: **Nikoll LESI**. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA



**BOTUES & DREJTOR:** Nikoll LESI
**KRYEREDAKTOR:** Daniel MUÇAKU
**ZV/KRYEREDAKTOR:** Redjon SHTYLLA
**BORDI:** Elsa KAMBERI, KRYETARE
**NIPT:** J71425013C

NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.